

FASIL

Mjet për impregnim hidrofob në sipërfaqet poroze. I prodhuar në bazë të silan-siloksanit

FUSHA E APLIKIMIT

Për impregnim hidrofob sipërfaqësor të sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme nga materialet poroze si: guri natyral, tullat, tjegullat, paver-elementet, pllakat e gjipsit etj.

CILËSITË

- Rezistent ndaj ujit;
- Avulldepërtues;
- Depërtues në sipërfaqet ku hidhet;
- E pengon absorbimin kapilar të ujit në sipërfaqet e trajtuara
- Nuk e ndërron pamjen sipërfaqësore;
- E shton qëndrueshmërinë e sipërfaqeve të trajtuara të akullit dhe kripërave.
- Kryerje(aplikim) i lehtë dhe i thjeshtë me furçë/rul ose spërkatje.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

CILËSIA	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Pamja	Vizuele	Le
Dendësia	EN ISO 2811-1	0.98 ÷ 1.02 g/cm ³
pH-vlera	ISO 4316	6 - 9

METODOLOGJIA E PUNIMIT (REALIZIMIT) PËRGATITJA E SIPËRFAQES BAZË:

Sipërfaqja bazë, e cila trajtohet me Fasil, duhet të jetë e pastër, pa pluhur dhe pa mbetje bojërash dhe vajrash. Pastrimi i sipërfaqes bazë bëhet me ajër ose ujë nën presion ose me sandblastim. Rekomandohet aplikimi i Fasil-it të bëhet në sipërfaqe të thatë.

APLIKIMI

Aplikimi i Fasil-it bëhet me furçë, rul ose me spërkatje. Materiali hidhet në një veprim punues deri në ngopje pa ndërprerje të aplikimit, derisa të mos përpunohet gjithë sipërfaqja. Mbi sipërfaqen e tharë nuk guxon të hidhet shtresë e re. Të evitohet qëndrimi i sasisë më të madhe të materialit mbi sipërfaqe. Nuk hidhet nëse temperatura e sipërfaqes është nën 5°C ose mbi 35°C, ose nëse pritet shi apo erë e fortë tri orët e ardhshme pas hedhjes së materialit. Para aplikimit materiali duhet të përzihet.

HARXHIMI

Harxhimi varet nga poroziteti i sipërfaqes bazë. Harxhimi i zakonshëm për një shtresë është 0,125 - 0,25 kg/m² te guri natyral, tjegullat, tullat dhe gjipsi, ndërsa të shumë sipërfaqe tjera poroze harxhimi është 0,3 - 0,5 kg/m². Aplikimi provues duhet të kryhet te të gjitha sipërfaqet me qëllim të caktimit të harxhimit të vërtetë.

PASTRIMI

Veglat dhe pajisjet pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit.

PAKETIMI


Shishe plastike prej 1 kg ;
Kanta(kanaçe) plastike prej 5 deri më 20 kg;
Fuçi plastike prej 200 kg;
Kontejner 1000 kg.

RUAJTJA(MAGAZINIMI)

Në ambalazh original të mbyllur, në hapësira të thata, në temperaturë nga 5°C deri më 30°C, të mbrojtura nga dielli dhe ngrirja. Afati i përdorimit: 12 muaj.



Pikë uji



Rrezik për jetë:

Fasil-i nuk përmban substanca toksike. Megjithatë, duhet pasur kujdes të mos vihet në kontakt me lëkurën, sytë ose të mos gëlltitet. Në rast të spërkatjes së lëkurës ose syve, duhet të shpërlahen me ujë të pastër. Nëse gëlltitet, duhet të kërkohet ndihmë mjekësore. Gjatë punës, sidomos gjatë spërkatjes, duhet të përdoren pajisje mbrojtëse (syze, maska dhe dorëza). Informata plotësuese janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit,

Zjarri: Fasil-i nuk ndizet. Informata plotësuese janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.

Pastrimi dhe ruajtja(deponimi): Pastrohet me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas rregullativës lokale dhe rregullativës për atë lloj mbeturinash. Informata plotësuese janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit: